



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 3633 prot.

Tiranë, më 31/08/2021

URDHËR

Nr. 376, datë 31.08.2021

**“PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT MBI KUJDESIN DHE MASAT ANTI COVID-19
NË STRUKTURAT ARSIMORE PARAUNIVERSITARE PËR VITIN SHKOLLOR
2021 – 2022”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe në zbatim të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me Nr. 1092, datë 27.08.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni Covid-19,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Udhëzimit “Mbi kujdesin dhe masat Anti covid-19 në strukturat arsimore parauniversitare për vitin shkollor 2021 – 2022”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. 1092 prot.

Tiranë, më 27.08 2021

U D H Ë Z I M

**MBI KUJDESIN DHE MASAT ANTI COVID-19 NË STRUKTURAT ARSIMORE
PARAUNIVERSITARE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022**

Hyrje

Detyra më e rëndësishme për hapjen e suksesshme të shkollave mbetet mirëqenia dhe mbrojtja e fëmijëve nga infeksioni që sjell sëmundjen e COVID-19. Për këtë arsye si më poshtë rekomandojmë:

I. KUJDESI PËR NXËNËSIN

Hyrja dhe dalja nga ambientet e shkollës

- Orari për hyrjen e nxënësve në shkollë rregullohet sipas një grafiku, hartuar nga drejtoria e shkollës dhe nën monitorimin e mësuesve të kujdestarisë ditore/javore.
- Nxënësit paraqiten në shkollë duke respektuar me përpikmëri orarin e komunikuar nga mësuesi kujdestar i tyre.
- Nxënësit hyjnë në shkollë pasi janë vendosur në radhë një nga një, me largësi jo më pak se 1.5 metra.
- Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar, i cili, në bashkëpunim me mjekun e shkollës ose atë të familjes verifikon nëse nxënësi është i sëmurë apo jo.
- Justifikimi i mungesës bëhet vetem nga mjeku i familjes.
- Personi përgjegjës i stafit të shkollës, i caktuar nga drejtori, duhet të kryej vlerësimin për çdo nxënësi si më poshtë vijon:

➤ Matje të temperaturës me termometër dixhital;

➤ Sprucim me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duar;

➤ Duhet të kontrollohen të gjithë nxënësit sipas grupmoshave, që të jenë të pajisur me maskë me një përdorim ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë) të cilat duhet të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si dhe shami letre për higjienën e hundëve;

- Nuk lejohet që nxënësit të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të, brenda ditës.
- Dera e shkollës do të qëndrojë e mbyllur, ndërsa dritaret e klasave ku zhvillohet procesi mësimor, rekomandohet të qëndrojnë të hapura për të krijuar ajrosjen e nevojshme brenda tyre.
- Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e shkollës.
- Dalja nga ambientet e shkollës do të bëhet sipas rregullave duke ruajtur distancimin social dhe fizik si me lart (jo më pak se 1.5 metra), nën mbikëqyrjen e mësuesve kujdestarë dhe të punonjësve të tjerë të shkollës. Drejtimi i vendosjes së femijëve vetëm në një kah apo një drejtim, njëri pas tjetrit.

Qëndrimi dhe mësimi në klasa

- Gjatë procesit mësimor, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit e tjerë, në 1.5 metra dhe mban në mënyrë të detyrueshme maskën përgjatë gjithë kohës, pavarësisht statusit të vaksinimit të tij.
- Brenda klasës, nxënësit qëndrojnë të ulur nga një nxënës në bankë, dhe bankat në të paktën 1.5 metra larg njëra-tjetrës. Në klasat ku kjo nuk është e mundur, nxënësit do të ndahen në klasa të tjera.
- Nëse transporti i nxënësve kryet me mjetet e transportit të dedikuara ose publik, duhet të mbahet maska gjatë gjithë kohës së transportit (vajtje-ardhje) dhe këto mjete duhet t'i nënshtrohen rigorozisht udhëzuesit për transportin.
- Nxënësve të ciklit të ulët 9-vjeçar, **u rekomandohet** të mbajnë maskë gjatë orëve të mësimi.
- Nxënësit e ciklit të lartë 9-vjeçar dhe të mesëm, **duhet** të mbajnë maskë në ambientet e brendshme dhe në të gjitha aktivitetet mësimore në ambientet e shkollës.
- Mësuesit sigurohen që në klasë të gjithë të jenë të pajisur me maskë dhe t'i mbajnë rregullisht ato (sipas specifikimit të grupmoshave).
- Nxënësit ndalohen të dalin nga klasa gjatë orëve të mësimi përveç rasteve kur i duhet të përdorin tualetet. Në këtë rast nxënësi duhet të shoqërohet.
- Kur është e mundur, praktikohet mësimi në ambient të hapur (oborr shkolle), duke respektuar largësinë dhe rregullat e mësipërme.
- Nuk lejohet ushqimi në klasë.
- Për nxënësit të cilët kanë sëmundje kronike apo patologji të tjera, sipas rekomandimeve dhe ndjekjes së protokollit nga mjekët klinikistë, mund të mbajnë maskë gjatë gjithë kohës në

ambjentet e klasës apo dhe gjatë aktiviteteve të tjera arsimore në shkollë, pavarësisht grupmoshës së rekomanduar më sipër.

Lëvizjet në mjediset e brendshme të shkollës

- Lëvizja e nxënësve në klasa, laboratorë, palestra dhe nëpër korridore duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë, që çdo zonë, të ketë numrin më të vogël të individëve që lëvizin në të. Kjo do të thotë, p.sh., nxënësit e klasës I^a do të hyjnë vetëm në sallën e përcaktuar për nxënësit e kësaj klase, do të përdorin vetëm tualetin në korridorin ku ndodhet klasa e tyre, pa u takuar asnjë moment me nxënës të klasave të tjera.
Rregullat për lëvizjen e nxënësve duhet të jenë të afishuara në ambjentet e klasave dhe në korridore.
- Nuk lejohen qëndrimet në korridore.
- Nxënësit, të mbajnë largësinë minimale të paktën 1.5 metra nga njëri-tjetri kur lëvizin në korridore dhe maskat sipas grupmoshave.
- Komunikimi, në rast nevojë, i nxënësit me drejtuesit, sekretarinë dhe stafin mësimor do të kryhet nëpërmjet mësuesit përgjegjës të katit, duke respektuar distancimin social e fizik dhe rregullat e tjera të përcaktuara më lart. Mund të jetë edhe nëpërmjet telefonit apo kompjuterit, kur nxënësi nuk ndodhet në klasë.
- Nuk do të përdoren sende personale të panevojshme për procesin mësimor.

Kujdesi për higjienën

- Nxënësit të ndërgjegjësohen dhe të mbahen në komunikim të vazhdueshëm për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë shkollës, nëpërmjet mesazheve sensibilizuese të shpërndara nga ekipi mjekësor dhe shërbimi psiko-social i shkollës.
- Nxënësve duhet t'u flitet rregullisht për rregullat e higjienës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes, teshtitjes dhe mbajtjen e maskës.
- Çdo nxënësi në shkollë, duhet të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve, gojës, etj.
- Të minimizohet prekja e herë pas herë me maskës, të kihet kujdes që gjatë heqjes të kryhet nga pjesa e pasme e maskës, të hedhet në kosh si dhe të kryhet larja e menjëherëshme e duarve apo përdorimi i desinfektantëve në fund të këtij procesi.
- Duhet të sigurohen nga struktura arsimore: uji i rrjedhshëm, sapuni i lëngshëm, letra për fshirjen e duarve dhe xhelë me përmbajtje alkooli 60%, në të gjithë ambjentet e shkollës.

- Gjatë qëndrimit në ambjentet e shkollës, çdo individ duhet të mbajë detyrimisht maskë (sipas specifikimit të grupmoshave).
- Klasat duhet të ajrosen në periudhën midis orëve të mësimi.
- Klasat duhet të kenë aq nxënës sa lejojnë distancimin jo më pak se 1.5 metra nga njëri nxënës tek tjetri.
- Nëse nxënësi manifeston gjëndje stresi dhe ankthi, ai i drejtohet shërbimit psiko-social të shkollës nëpërmjet mësuesit kujdestar dhe “Këndit të psikologut” online pranë DRAP-së .
- Në një klasë apo sallë laboratorit, të mos qëndrojnë më shumë nxënës sesa mund të qëndrojnë në atë mjedis, duke respektuar distancimin social dhe fizik.
- Aktivitetet sportive e artistike në ambjentet e shkollës, duhet të kryhen në grupe jo më shumë se 10 persona dhe duke ruajtur distancimin fizik.
- Të jenë të afishuara në të gjitha ambjentet e shkollës, postera mbi masat e parandalimit të infeksionit COVID-19 dhe postera me mesazhe të qarta dhe të thjeshta.
- Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve dhe mbajtjes së maskës.
- Në hyrje dhe dalje të ambjenteve të shkollës, rekomandohet të vendoset një higjenzues për duart në trajtë solucioni me përmbajtje aktive të alkoolit 60%, i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm
- Të kryhet dezinfektimi i çdo klase, çdo ditë. Pas përfundimit të procesit mësimor, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orëdivave me lëndë dezinfektuese.
- Dezinfektim i mjediseve të brendshme dhe të jashtme të shkollës, rekomandohet të kryhet pas procesit mësimor 2 herë në javë.
- Përpara se të rifillojnë mësimin në ambjentet e shkollës sipas rregulloreve të reja për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nxënësit duhet të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit për situatën e tyre shëndetësor dhe të familjarëve të tyre, e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni COVID-19.

II. KUJDESI PËR MËSUESIN

- Gjatë orës së mësimi, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit.
- Mësuesi, duhet të mbajë maskës në mjediset e shkollës përgjatë gjithë kohës, pavarësisht nga statusi i tij i vaksinimit.
- Mësuesi, nëse ka persona të sëmurë në familje me COVID -19 duhet ta deklarojë atë dhe zbatojë periudhën e karantinës pavarësisht statusit të tij të vaksinimit.
- Mësuesi, të duhet të deklarojë statusin e vaksinimit dhe të depozitojë kartën e vaksinimit ose fotokopje të saj pranë drejtorisë të shkollës.
- Mësuesit duhet të jenë të vaksinuar përpara fillimit të procesit mësimor.

- Nëse mësuesit nuk janë vaksinuar përpara fillimit të procesit mësimor duhet të merren masa për vaksinimin e tyre. Në vijim të vendimit të Komitetit të Eksperëve brenda datës 30 shtator 2021 çdo mësues duhet të vaksinohet.
- Në rast se mësuesi nuk është i vaksinuar duhet të dorëzoj dokumentin e mjekut të familjes ku të specifikohet arsyeja e mosvaksinimit.

III. KUJDESI PËR PERSONELIN NDIHMËS

Sanitarët

- Sanitarët, duhet të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën dhe të përdorin solucione dezinfektuese.
- Korridoret pastrohen çdo dy orë.
- Tualetet pastrohen e dezinfektohen shpesh, sipas orareve të përcaktuara dhe të afishuara.
- Rezervuarëve të ujit që mund të ketë shkolla, u hidhet klor sipas udhëzimeve përkatëse çdo ditë .
- Dorezat e dyerve dhe dritareve të çdo klase dhe mjedisi pune si dhe parmakët e shkallëve dhe vende të tjera pastrohen dhe dezinfektohen sa më shpesh.
- Largimi nga institucioni arsimor bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo mjedisi të tij.
- Kryejnë të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit.
- Sanitarët, nëse kanë persona të sëmurë në familje me COVID -19, duhet të deklarojnë atë dhe të zbatojnë periudhën e karantinës, pavarësisht statusit të tyre të vaksinimit.
- Sanitarët, duhet të deklarojnë statusin e vaksinimit dhe të depozitojnë kartën e vaksinimit ose fotokopje të saj pranë drejtorisë së shkollës.
- Sanitarët, duhet të jenë të vaksinuar përpara fillimit të procesit mësimor.
- Nëse sanitaret, nuk janë vaksinuar përpara fillimit të procesit mësimor duhet të merren masa për vaksinimin e tyre.
- Në rast se sanitari nuk është i vaksinuar duhet të dorëzoj dokumentin e mjekut të familjes ku të specifikohet arsyeja e mosvaksinimit.

Roja i institucionit/oficieri i sigurisë

- Roja/oficieri i sigurisë duhet të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, të përdori solucione dezinfektuese.
- Roja nuk lejon prezencën e prindërve dhe çdo individ tjetër brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve dhe personelit të deklaruar të institucionit arsimor).

- Çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të drejtorit ose të stafit drejtues.
- Kryen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit, dhe personelin ndihmës, duke mbajtur masken përgjatë gjithë kohës pavarësisht statusit të vaksinimit.
- Personeli që shërben dhe rojet nëse ka persona të sëmurë në familje me COVID -19 duhet të deklarojnë atë dhe të zbatojnë periudhën e karantinës, pavarësisht statusit të tyre të vaksinimit
- Personeli që shërben dhe rojet duhet të deklarojnë statusin e vaksinimit dhe të depozitojnë kartën e vaksinimit ose fotokopje të saj pranë drejtorisë së shkollës.
- Personeli që shërben dhe rojet duhet të jenë të vaksinuar përpara fillimit të procesit mësimor
- Nëse, personeli që shërben dhe rojet nuk janë vaksinuar përpara fillimit të procesit mësimor duhet të merren masa për vaksinimin e tyre.
- Në rast se roja/personeli i sigurisë nuk është i vaksinuar duhet të dorëzojë dokumentin e mjekut të familjes ku të specifikohet arsyeja e mosvaksinimit.

IV. KUJDESI PËR PRINDIN

- Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike tek mësuesi apo mësuesi kujdestar këtë udhëzim.
- Plotëson formularin e vetëdeklarimit ditor me përgjegjësi për gjendjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të mësuesit kujdestar.
- Deklaron statusin e tij të vaksinimit dhe familjarëve që banojnë me të.
- Deklaron ose njofton menjëherë shkollën nëse ka persona me COVID-19 në familje.
- Në rast nevojë për komunikim me mësuesin, drejtuesi përdor komunikimin elektronik dhe në rastet e planifikuara takimet ballë për ballë.
- Në rastet e shoqërimit të fëmijës/fëmijëve në shkollë, nuk duhet të futet brenda mjedisit të shkollës.
- Nëse prindi futet në mjediset e shkolles, ai duhet detyrimisht të sigurojë mbajtjen e maskës.

V. KUJDESI PËR DREJTUESIT

- Ngrenë grupe pune dhe hartojnë planet e veprimit për menaxhimin e situatës, garantimin e standardeve dhe respektimin e rregullave të përcaktuara më këtë rregullore.
- Monitorojnë pajisjen e nxënësve dhe të stafit me mjetet mbrojtëse, si: maskë, xhel dezinfektues për përdorim personal (sipas mundësive).
- Sigurojnë ventilimin e duhur të çdo mjedisi në shkolle.

- Mbajnë kontakte, përmes komunikimit elektronik, me njësinë e vetëqeverisjes vendore, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, strukturat e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor.
- Për çdo fëmijë, i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh: rritje të temperaturës etj., apo ka njoftim nga prindi; ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë apo ka patur kontakte me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.
- Për çdo mësues apo personel tjetër të shkollës i cili paraqet probleme shëndetësore si p.sh. rritje të temperaturës etj., apo ka njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.
- Kontrollonin statusin e vaksinimit ndaj COVID -19 të mësuesve dhe personelit që shërben dhe sigurojnë që mësuesit dhe personeli që shërben janë të vaksinuar ndaj COVID-19.
- Kontrollonin dhe sigurojnë që izolimi dhe karantina zbatohet për mësuesit, personelin që shërben, nxënësit dhe prindërit e tyre, pavarësisht statusit të tyre të vaksinimit.
- Sigurojnë në bashkëpunim me NJVKSH-në përkatëse, nëse mund të kryejnë aktivitete, në të cilat mund të grumbullojnë nxënësit.
- Në shkollat ku mund të ofrohet ushqim, pezullohet konsumi i ushqimit në mjedise të përbashkëta.
- Drejtuesit e strukturave arsimore, duhet të ndjekin me rigorozitet protokollin e kontrollit të riskut të miratuar nga autoritetet shëndetësore.

Instituti i Shëndetit Publik, rezervon të drejtën të rivlerësojë elementët e këtij udhëzuesi, në rast të ndryshimeve epidemiologjike të COVID-19 dhe të dhënave të tjera në drejtim të vaksinimit dhe testimit.

DREJTOR

Albana FICO

